




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPKI</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>06-1432/20</u>
Nr. Filaq Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>06-07-2020</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 06.07.2020, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-1117/20*, për zyrtarin e lartë z. Imri Jashari, Drejtor i Klinikës së Kardiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Imri Jashari, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë z. Imri Jashari, Drejtor i Klinikës së Kardiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, njëkohësisht është edhe person i autorizuar në biznesin privat: "Imri Jashari" B.I. (N.Sh.T. Poliklinika "Koronarja").

Agjencia kundër Korrupsionit, me qëllim të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesit ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) informatat për biznesin në fjalë (shkresa zyrtare: DPKI-06-516/20). Nga informata për biznesin të cilën Agjencia Kundër Korrupsionit e ka pranuar nga ARBK (shkresa zyrtare: DPKI-06-01/516/20), është konstatuar se zyrtari i lartë z. Imri Jashari, është person i autorizuar në biznesin e sipërsëhënuar.



Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-1278/20, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, zyrtari i lartë z. Imri Jashari është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerret për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohej me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Zyrtari i lartë z. Imri Jashari, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmangë gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar informatën (DPKI-1278-1/20), me të cilën dëshmohej se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznes.

Pas analizimit të informatës mbi biznesin, Agjencia kundër Korrupsionit konstatoi se zyrtari i lartë z. Imri Jashari, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.1 lidhur me nenin 15 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

